

FUNKSIONIMI



I SHTETIT

DEMOKRACIA ATËHERË DHE SOT

LEND (12), ALKETA (12), QENDRESA (12), MAL (12), DRIN (12), ADEA (12), ISMAIL (12), DION (12),
BLEND (12)



Ka sisteme të ndryshme të qeverisjes por ne jemi të lumtur që kemi sistemin demokratik

Demokracia filloi në vitin 507 para erës sonë në Athinë. Atëherë, demokracia ishte shumë më ndryshe se në ditët e sotme. Në atë kohë, vetëm burrat që kishin prona lejoheshin të merrnin pjesë në mbledhje në të cilat merreshin vendime për shtetin. Kurse, grave dhe skllëvëverve nuk u lejohej pjesëmarrja në ato mbledhje.

Fjala demokraci rrjedhë nga fjala greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë pushtet. Demokracia është sistem i qeverisjes, ku populli i zgjedh përfaqësuesit e vet. Çdo person duhet t'i ketë të drejtat dhe të jetë i barabartë. Kur filloi të zhvillohet demokracia, atëherë nuk ishin të gjithë të barabartë.

Për dallim nga demokracia e atëhershme, demokracia sot është shumë më e zhvilluar dhe të gjithë jemi të barabartë para ligjit. Janë të njohura dy lloje të demokracisë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese.

QEVERIA

Qeveria është e përbërë nga: Kryeministri, ministrat, zv. kryeministrat, zv.ministrat. Secili nga këta kanë detyrat e veta. Qeveria përfaqën Pushtetin Ekzekutiv në Kosovë.

Qeveria propozon buxhetin, propozon ligjet dhe i dërgon në Kuvend, si dhe merret me çështjet e brendshme dhe të jashtme të shtetit, rregullon ekonominë e vendit, etj.



Duke punuar artikullin




Autorët e artikullit

DEMOKRACIA DHE NDARJA E PUSHTETIT

REIS (12), DION (12), YLL (12), ELSA A (12), ELSA LL (12), ERION (12), ERSJA (12), DAFINA (12)

Ky artikull flet për mendimet tona në lidhje me demokracinë dhe ndarjen e pushtetit

Demokracia është forma më e mirë e udhëheqjes. Ajo është udhëheqje e popullit. Demokracia ua lehtëson punën Kuvendit, Qeverisë dhe gjykatave. Kuvendin e përbëjnë deputetët, të cilët i miratojnë ligjet dhe pastaj ato ligje i zbaton Qeveria, kurse gjykata vendos drejtësi në vend. Gjykata ndahet në Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit, dhe Gjykatën Supreme. Ligjet e marra në Kuvend bazohen në Kushtetutë. Kushtetuta është libri i madh me shumë nene. Ndërsa degët e pushtetit janë: Pushteti Gjyqësor, Pushteti Legjislativ dhe Pushteti Ekzekutiv. Në Pushtetin Ekzekutiv bën pjesë Qeveria, Pushtetin Legjislativ e përbën Kuvendi, ndërsa Pushtetin Gjyqësor e përbën gjykata.




Pema e pushtetit



Fëmijët gjatë punës



Barazi vlenë për të gjithë




Ndarja e pushtetit



Demokratët e rinj

KUVENDI DHE DEPUTETËT

LEUTRIM (12), ARTA (12), MALSOR (13), OLSA (12), ALBANA (12), ALKETA (12), DENIZI (12), RRONI (12)




Kuvendi dhe deputetët e Republikës së Kosovës

Kuvendi është vendi ku diskutohen çështje të ndryshme dhe merren vendime të rëndësishme për ne. Kuvendi është vendi ku bëhet votimi i projektligjeve. Aty nxirren ligjet dhe miratohen. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka 120 deputetë dhe 20 prej tyre janë nga komunitetet jo shumicë. Tri funksionet e Kuvendit janë: përfaqëson popullin, mbikëqyr Qeverinë, miraton ligjet. Në Kuvend bëhet votimi i projektligjeve. Kuvendi i trajton të gjithë në mënyrë të barabartë pa dallim feje, kombi, gjinie etj. Gjithashtu, në Kuvend shqyrtohen tema të ndryshme. Për deputet ka të drejtë të konkurojë çdo shtetas i Kosovës mbi moshën 18 vjeçare. Kuvendi bën pjesë në Pushtetin Legjislativ, sepse propozon dhe miraton ligje. Deputetët marrin pjesë në parti të ndryshme dhe secila prej këtyre partive ka qëllime të ndryshme për të



mirën e qytetarëve. Kandidatët për deputetë duhet të kenë planprogramet e tyre që i paraqesin para popullit. Ata para se të vihen në detyrë, duhet të betohen që do ta kryejnë detyrën e tyre dhe ta përfaqësojnë popullin me dinjitet. Deklaratën e betimit e lexon Kryetari i Kuvendit e pastaj të gjithë deputetët e rinjë konsiderohen zyrtarisht deputetë. Edhe ne sot patëm rastin të lexojmë deklaratën e betimit.



Jemi të lumtur që jetojmë në një shtet demokratik

QYTETARIA AKTIVE

ADEA (12), AGNESA (12), ELONIDA (12), HENOR (12), MOLOS (12), BLEND (12), FLORENT (13)


LEART (12)

Roli ynë si qytetarë të mirë


Ne si qytetarë kemi rol shumë të rëndësishëm. Kemi të drejta, por ne kemi edhe përgjegjësi. Një ndër përgjegjësitë tona është mbrojtja e ambientit. Votimet, protestat, peticionet, referendumet janë disa nga mënyrat që qytetari mund të jetë aktiv. Mirëpo, gjithsesi respekti është një ndër përgjegjësitë që kemi. Ne kemi të drejtë të shkollohemi dhe të jemi të barabartë. Ne kemi të drejta të ndyshme si e drejta e shkollimit, e drejta e shprehjes, e drejta e lojës, e drejta e pushimit etj. Qytetarët duhet të jenë të mirë të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe jo të dëmtojnë popullin. Vota jonë duhet të jetë e lirë.



Autorët e artikullit



Përgjegjësia e mbrojtjes së ambientit iu takon të gjithëve



Secili qytetar ka të drejta dhe përgjegjësi



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „MODEL“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë